STIFTUNG FLEXIBLER ALTERSRÜCKTRITT
FONDATION RETRAITE ANTICIPÉE
FONDAZIONE PENSIONAMENTO ANTICIPATO

Fondacioni për pensionimin e parakohshëm f a r

# UDHËZUES PËR NGRITJEN E KONTRIBUTEVE FAR

## Ngritja e kontributeve FAR nga 5 % në 7%

Nga 1 korriku 2016 do të ngriten kontributet FAR për punëdhënësit nga 4 % në 5,5 % dhe kontributet FAR për punëmarrësit nga 1 % në 1,5 %.

**Punëdhënësit pra nga fundi i korrikut 2016 duhet t´ua zbresin punëmarrësve kontributin e rritur prej 1,5 % nga rroga.**

## Arsyet e ngritjes së kontributeve

Ngritja e kontributeve FAR është bërë e nevojshme sepse prognoza matematikore e sigurimit për vitet e ardhshme pret rritjen e kërkesave të pensioneve të ndërmjetme.

Kjo ndodh në njërën anë për arsye se vitet me lindje të fuqishme arrijnë moshën minimale për pensionim (60) dhe në anën tjetër gjithnjë e më shumë punonjës përdorin mundësinë për pensionim të parakohshëm.

Deri në fund të vitit 2015, 14.951 persona kanë përdorur mundësinë e pensionimit të parakohshëm.

## Informacione

Informacionet në lidhje me parakushtet për pensionin FAR mund të gjeni në www.far-suisse.ch/leistungen.

Korrik 2016